



RAPORTI I PUNËS SË KKSBB-së PËR PESË (5) MBLEDHJET E VITIT 2019

Nga: Kryetari i Komunës z. Smajl Latifi.

Pikat e rendit të ditës nga mbledhja e KKSBB-së e mbajtur me 29.01.2019

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Veprimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019,
2. Informim rreth gjendjes së sigurisë së përgjithshme në Komunën e Rahovecit
 - Analiza e sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit për vitin paraprak,
 - Siguria në Trafik,
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e Planit për siguri në shkolla,
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit.
3. Të ndryshme

KONKLUZAT

1. Pika e parë e rendit të ditës: aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, është aprovuar në mënyrë unanime, pa asnjë vërejtje.
2. Lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës, shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Veprimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2019, ky plan është aprovuar me propozimin e dy pikave shtesë nga ana e OSBE-së, në mënyrë unanime nga anëtarët e KKSBB-së.
3. Lidhur me pikën e tretë të rendit të ditës është konstatuar se gjendja e sigurisë së përgjithshme në komunën e Rahovecit, është e qetë dhe stabile.

Komandanti i Policisë në Rahovec ka konstatuar se gjendja e sigurisë për vitin 2018 ka qenë e qetë dhe stabile, po ashtu ka konstatuar se nëse bëhet krahasimi me vitin e kaluar ky vit ka pasur rënje të krimit dhe të vjedhjeve.

Por ajo që është më shqetësuese është rritja e aksidenteve të trafikut, ku sipas Komandantit të Policisë në Komunën tonë nuk ka pasur asnjë rast të aksidentit me fatalitet.

Kryetari i Komunës së Rahovecit konstatoi se: Duke filluar nga ne dhe gjithë qytetarët e Komunës, duhet që të mobilizohemi për t'i ndihmuar policisë së Kosovës dhe të kontribuojmë në forcimin e sigurisë në komunikacion. Ta ulim krimin si në komunën tonë, po ashtu edhe sa i përket sigurisë në shkolla duhet të gjithë përmes përgjegjësi të veta të bëjmë të pamundurën që këto që i përmenda më parë të zvogëlohen sa më shumë.

4. Të ndryshme:

Në këtë pikë nuk është diskutuar diçka me rëndësi për tu cekur.

Pika e rendit të ditës nga mbledhja e KKSB-së e mbajtur me 15.03.2019

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit,
 - Trotuaret, lirimi i tyre dhe shenjat sinjalizuese,
 - Qentë endacak,
 - Siguria ne Trafik,
 - Vetëdijesimi i qytetarëve dhe parandalimi i zjarreve,
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit,
3. Organizimi i Takimit Publik me qytetarët dhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane,
4. Të Ndryshme.

KONKLUZAT

1. Pika e parë e rendit të ditës: aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, është aprovuar në mënyrë unanime, pa asnjë vërejtje.
2. **Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit**
Lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës është konstatuar se gjendja e sigurisë së përgjithshme në komunën e Rahovecit, është e qetë dhe stabile, pa kurrfarë incidenti i cili duhet veçuar.

Komandanti i Policisë në Rahovec ka konstatuar se gjendja e sigurisë për muajin janar – shkurt e vitit 2019 ka qenë e qetë dhe stabile, po ashtu duke ka konstatuar se nëse bëhet krahasimi me dy muaj e vitit të kaluar këto dy muaj të këtij viti ka pasur rënje të krimit dhe të vjedhjeve.

Sipas komandantit të policisë në Komunën tonë nuk ka pasur asnjë rast të aksidentit me fatalitet.

Sa i përket sigurisë nëpër shkolla, në këto dy muaj ka pasur vetëm një incident në shkollën e mesme "Ukshin Hoti" në Krushë të Madhe, incidente të tjera nuk ka pasur.

Kryetari i Komunës së Rahovecit konstatoi se: Duke filluar nga ne dhe gjithë qytetarët e Komunës, duhet që të mobilizohemi për t'i ndihmuar Policisë së Kosovës dhe të kontribuojmë në forcimin e sigurisë në komunën tonë, përgjegjësi të veta të bëjmë të pamundurën që këto që i përmenda më parë të zvogëlohen sa më shumë.

Ajo që është më shqetësuese është ndezja e qëllimshme e objekteve të komunës, në këtë rast një shtëpizë të cilën e kanë djegur tek Epopeja e UÇK-së, si dhe ndezja e zjarrit të disa fushave dhe maleve.

Kryetari së bashku me komandantin e policisë u zotuan se do të bëjnë çmos për të zbuluar se kush qëndron prapa këtyre ndezjeve të qëllimshme.

3. **Organizimi i Takimit Publik me qytetarët dhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane,**

Sa i përket pikës së tretë të rendit të ditës, Kryetari i Komunës tha se brenda javës do ta mbaj një takim me kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane, po ashtu do t'i njoftoj për agjendën e debateve publike për secilin fshat dhe lagje urbane, që nga data 3 prill deri me 7 mars Kryetari i Komunës do të mbaj takim me banorë të secilit fshat, dhe pastaj do t'i njoftoj anëtarët e KKSB-së rreth asaj se çka u bisedua në këto debate.

4. **Të Ndryshme.**

Në këtë pikë anëtari i KKSB-së z. Nysret Abazibra, Kryemami i Bashkësisë Islame të Rahovecit, kishte një kërkesë që në mbledhje të radhës si pikë e rendit të ditës të jetë një raport sa i përket të dhënëve, se sa lokale të lojërave të fatit janë në komunën tonë, sa janë legale dhe sa ilegale, pastaj a ka ndonjë statistikë se sa është numri i përdorueseve të drogës në komunën e Rahovecit. Në mënyrë që pastaj anëtarët e KKSB-së të bëjnë një fushatë nëpër shkolla dhe institucione të ndryshme kundra këtyre dukurive negative.

Pikat e rendit të ditës nga mbledhja e KKSB-së e mbajtur me 26.04.2019

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit,
 - Shqyrtimi i dukurive negative, me theks të veçantë trajtimi i objekteve jo të sigurta në Komunën e Rahovecit,
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
 - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit,
 - Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për parandalimin nga zjarri gjatë sezonit veror,
3. Të Ndryshme.

KONKLUZAT

1. Sa i përket pikës së parë të rendit të ditës: **Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**, është aprovuar në mënyrë unanime, pa asnjë vërejtje.
2. **Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit** Kryetari i Komunës në pikën e dytë të rendit të ditës ka konstatuar se gjendja e sigurisë së përgjithshme në komunën e Rahovecit, është e qetë dhe stabile, pa kurrfarë incidenti i cili duhet veçuar.

Shefi i Operativës i Policisë në Rahovec Z. Bekim Vuçitërna ka konstatuar se gjendja e sigurisë për muajin janar –mars të vitit 2019 ka qenë e qetë dhe stabile, po ashtu ka konstatuar se nëse bëhet krahasimi me tre muajt e vitit të kaluar këto tre muaj të këtij viti ka pasur rënje të krimit dhe të vjedhjeve.

Sipas togerit të policisë në Komunën tonë nuk ka pasur asnjë rast të aksidentit me fatalitet.

3. Të Ndryshme.

Sa i përket pikës së fundit nuk ka pasur diçka me rëndësi e cila duhet raportuar.

Pikat e rendit të ditës nga mbledhja e KKS-së e mbajtur me 12.06.2019

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit,

- Masat për parandalimin e lëmshë-kërkuesit,
- Plani operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave,
- Gjendja e sigurisë në shkolla,
- Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
- Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit,
- Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për parandalimin nga zjarri gjatë sezonit veror,

3. Sensibilizimi i qytetarëve për rendësinë e promovimit të bashkëpunimit ndër-etnik, multi - kulturor dhe ndër-fetar,

4. Të Ndryshme.

KONKLUZAT

1. Pika e parë e rendit të ditës aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, është aprovuar në mënyrë unanime, pa asnjë vërejtje.
2. **Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit.**
Nënkryetari i Komunës z.Fatmir Iska në pikën e dytë të rendit të ditës në hapje të mbledhjes së KKS-së, tha se për situatën e sigurisë në gjithë territorin e komunës nga zyrtarët përgjegjës marrim raporte në kohë reale, si nga Policia e Kosovës stacioni në Rahovec, bazuar në ato raporte nuk kemi parë diçka që e cenon sigurinë në komunën e Rahovecit dhe mund të them se situata e sigurisë është pozitive, e qetë, stabile dhe e qëndrueshme.

***Komandanti i Stacionit Policor në Rahovec, z. Fazli Morina** - Ka konstatuar se gjendja e sigurisë për muajt prill –maj të vitit 2019 ka qenë e qetë dhe stabile, po ashtu ka konstatuar se nëse bëhet krahasimi me tre muajt e vitit të kaluar këto tre muaj të këtij viti ka pasur rënje të krimit dhe të vjedhjeve. Komandanti Morina u shpreh se masat për parandalimin e lëmshë- kërkuesve, Policia e Kosovës ka në implementim planin operativ e që është i veçantë për lëmshë-kërkuesit, nga statistikat që kemi për dallim nga komunat tjera, komuna e*

Rahovecit ka një numër të vogël të lëmoshë-kërkuesve, mirëpo duhet angazhim edhe nga institucionet tjera si Qendra për Punë Sociale. Gjatë periudhës janar deri në përdhën raportuese nuk kemi pasur asnjë rast, kurse gjatë vitit 2018 kanë qenë 3 raste, lëmoshë-kërkuesit janë nga Republika e Shqipërisë. Policia e Kosovës e ka planin operativ të veçantë për sezonin e pushimeve të mërgimtareve dhe dasmave, plan të cilin ne do të implementojmë në tërësi, ne veçanti gjatë muajve korrik-gusht dhe sigurisht që do të ketë edhe rezultatet pozitive.

3. Sensibilizimi i qytetarëve për rendësinë e promovimit të bashkëpunimit ndër-etnik, multi - kulturor dhe ndër-fetar.

Nënkryetari - Të nderuar, kjo pikë gjatë hartimit të planit të punës së KKS-së për vitin 2019, na ka ardhur si kërkesë e OSBE-së që të përfshihet në plan. Mendoj se OSBE-ja gjatë muajit korrik do të organizojë një aktivitet, ku do të organizojë një turnirë të vogël në futboll ose në volejboll, ku pjesëmarrës do të jenë anëtarët e KKS-së, pastaj komuniteti serb, Romë, Ashkali, dhe Egjiptas, mundemi të themi se të gjitha komunitetet që jetojnë në komunën e Rahovecit. Pas përfundimit të këtij aktiviteti sportiv në fund do të ketë një darkë e përbashkët e cila po ashtu organizohet nga OSBE-ja.

4. Të Ndryshme.

Sa i përket pikës së fundit nuk ka pasur diçka me rëndësi e cila duhet raportuar.

Pikat e rendit të ditës nga mbledhja e KKS-së e mbajtur me 04.09.2019

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit,

- Prishja e qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e papërgjegjshëm,
- Trajtimi i mbrojtjes së pyjeve nga dëmtuesit ilegalë,
- Vetëdijesimi nga minat dhe mjetet tjera të pa shpërthyer nga lufta,
- Gjendja e sigurisë në shkolla,
- Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta,
- Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
- Siguria në trafik,
- Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje,
- Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit,

3. Të Ndryshme.

KONKUZAT

1. Pika e parë e rendit të ditës **Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**, është aprovuar në mënyrë unanime, pa asnjë vërejtje.
2. **Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit Kryetari i Komunës z. Smajl Latifi** në pikën e dytë të rendit të ditës të mbledhjes së KKSBS-së, tha se për situatën e sigurisë në gjithë territorin e komunës nga zyrtarët përgjegjës marrim raporte në kohë reale, si nga Policia e Kosovës stacioni në Rahovec, bazuar në ato raporte nuk kemi parë diçka që e cenon sigurinë në komunën e Rahovecit dhe mund të them se situata e sigurisë është pozitive, e qetë, stabile dhe e qëndrueshme.

Komandanti i Stacionit Policor në Rahovec, z. Fazli Morina - Ka konstatuar se gjendja e sigurisë për muajin qershor-gusht të vitit 2019 ka qenë e qetë dhe stabile, po ashtu ka konstatuar se nëse bëhet krahasimi me tre muajt e vitit të kaluar këto tre muaj të këtij viti ka pasur rënje të krimit. Komandanti Morina u shpreh se gjobat për prishje të rendit dhe qetësisë publike janë shqiptuar gjithsej 12, me kompetencat e reja që u janë dhënë nga gjykatat. Po ashtu komandanti potencoi se janë kryer gjithsej 44 vizita në shkollat e komunës së Rahovecit, ku nuk kemi pasur ndonjë shqetësim i cili duhet raportuar në këtë mbledhje. Kurse sa i përket sigurisë në trafik, mundem t'iu them se është shumë shqetësuese, janë shqiptuar gjithsej 1392 gjoba. Kemi pasur dy aksidente me fatalitet ku kanë humbur jetën 6 persona, flas gjithmonë për 3 muajt e fundit qershor – gusht 2019, aksidente me dëme materiale kemi pasur gjithsej 34, aksidente me lëndime trupore 49, ku kanë qenë të përfshirë 109 persona. Kurse sa i përket dhunës në familje mund t'iu them se është shqetësuese për këto 3 muajt e fundit, kemi pasur 14 raste të dhunës në familje, ku janë të arrestuar gjithsej 13 të dyshuar, por nuk janë gjithmonë viktimë të dhunës gjinia femërore, kemi edhe të gjinisë mashkullore që janë viktimë e dhunës në familje.

Konkluzion nga Kryetari i Komunës për mbledhjen e datës 04.09.2019 - Kërkoj nga Policia e Republikës së Kosovës si dhe nga Inspektorati i Komunës së Rahovecit, që të bëjë lirim të trotuareve nga makinat e parkuara si dhe nga ekspozimi i mallrave të ndryshëm që bëhet në trotualet e qytetit. Konkluzioni tjetër është që të dalin në teren Policia së bashku me Inspektoratin e Komunës që të bëjë kontroll mos ka ndonjë veprimtari të lojërave të fatit të Komunës së Rahovecit, sepse ato tanimë janë të ndaluara me ligj. Konkluzioni i fundit është që të ndalohet eksploatimi i zhavorrit në Komunën e Rahovecit.

3. **Të Ndryshme.**
4. *Sa i përket pikës së fundit nuk ka pasur diçka me rëndësi e cila duhet raportuar.*

Skender Hamza

Kordinator i KKSBS-së